



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0255

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-Kryetar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " ARCHI TIME " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjen dy korriku në Prizren" projekt dyvjeçar me numër të prokurimit; 622-23-14181-5-1-1, me 03/07/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Archi Time" Sh.P.K." me nr. 2024/255 , kundër vendimit të AK, Komuna e Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve ne lagjen dy korriku ne Prizren, projekt dyvjeçar" me nr. të prokurimit: "622-23-14181-5-1-1", të iniciuar nga Komuna Prizren.

2. Anulohet "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 06.03.2024, i Autoritetit Kontraktues, Komuna Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër; "622-23-14181-5-1-1", dhe lënda kthehet në Rivlersim.

3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik "Archi Time" Sh.P.K." , sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.12.2023 Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve ne lagjen dy korriku ne Prizren. projekt dyvjeçar" me nr. të prokurimit: "622-23-14181-5-1-1". Ndërsa me datën 06.03.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me

kontratë GOE “ Sedtours Sh.P.K.; Eurovia Sh.P.K.; Companya Eskavatori Sh.P.K.”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 2.480,000.00€.

Me 11.03.2024 OE “Archi Time” Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 15.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.03.2024 OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Archi Time” Sh.P.K.” me nr. 255/24 për lidhur me aktivitetin “Rregullimi i rugeve dhe trotuareve ne lagjen dy korriku ne Prizren. projekt dyvjeqar” me nr. të prokurimit: “622-23-14181-5-1-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Archi Time” Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “Grupi i Operatoreve Ekonomik i shpallur nga Autoriteti Kontraktues si tenderues i suksesshëm nuk e plotëson këtë kërkesë, gjegjësisht Kërkesën 3.1 dhe 3.3 në DT, Dëshmi mbi përvojën e punës të Inxhinierit të Licencuar nga MPMS për Menaxhimin e Emergjencave në lëmin e Sigurisë, Mbrojtjes dhe Shëndetit në Punë b) CV-ia dhe Dëshmi mbi përvojën e punës të Ekspertit për SSHP (siguri dhe shendet ne pune) të certifikuar nga MPMS..”

Pretendimi i dytë (II) : “I mungon 1 (nje) Kamion i tonazhit nga 15 deri 20 ton pesha bartese.”

Pretendimi i tretë (III): “I mungojnë kontratat e punës ose kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt për stafin e trajnuar dhe të certifikuar për SSHP (siguri dhe shendet në punë).”

Pretendimi i katërt (IV) : “Operatori Ekonomik në Paramasë ka një gabim të vogël aritmetik në vlerë prej 200.00 €, ku Autoritetit Kontraktues i ka i kur pa e vërejtur.”

Pretendimi i pestë (V) : “Në letrën e Autoritetit Kontraktues “Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues” Arsyeja e pretenduar nga AK për eliminimin tonë nuk qendron.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “Archi Time” Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 69 LPP-së . Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë anulimin e vendimit për vendimin e tenderuesit të suksesshëm i cili vendim është bere ne shkelje te rende te LPP-se dhe Ligjeve ne fuqi dhe këtë lende ta ktheje ne rivlerësim duke respektuar dispozitat e LPP-s. I rezervojmë te gjitha te drejtat tona ligjore qe te mbahemi te informuar ne te gjitha fazat e këtij procesi.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim :

OE “Archi Time” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjen dy korriku në Prizren. projekt dyvjeqar Me nr të Prokurimit 622-23-14181-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 15. 03. 2024 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pabazuar për arsyet në vijim: Edhe në procesin e rishqyrtimit të kërkesës tuaj, Autoriteti kontraktues konstaton se qëndrojnë të gjeturat e

komisionit të vlerësimit të ofertave siç janë: Kërkesa 5- të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike- Mungojnë këto pajisje teknike. Një ngjeshës cilindër 25-30 ton. Luge Ngarkuese me zingjir 20 deri 22 ton – 1 cope. Ngarkues 32 deri 35 ton – 1 cope. Makinë ngjeshëse e montuar në eskavator 800 deri 1000kg – 1 cope. Greder 8 deri 12 ton – 1 cope. Greder 18 deri 20 ton – 1 cope. Bulldozer 10 deri 15t – 1 cope. Kompresor ajri me tërheqje me regjistrim valid – 1 cope. Luge me nofulla shtrënguese hidraulike 1500 deri ne 2000 kg – 1 cope. Kërkesa 7- Prodhuesi i pllakave për hapësira te jashtme të jetë i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi për menaxhimin e cilesise) për sistem hermetik te makinerisë prodhuese. Produkti te plotësoj standardet në vazhdim EC ose DOP (Declaration of Conformity). Produkti të posedoj shenjën CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 (mungon dëshmia e kërkuar te prodhuesi i pllakave për hapësira te jashtme te jete) Dëshmia 9 raportet e testimit sipas standardit EN 13748-2 për pozicione e paramases me nr.(1.4.10) sipas standardit dhe për pozicionet (1.4.10). Si dëshmi të ofrohen certifikatat me standardet EC (Declaration of Conformity) në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive). (mungojnë dëshmitë e kërkuara te Iso standardit) (mungon dëshmia e kërkuar).Vëmendje: Gjate procedurave te tenderimit ofertuesi duhet te prezantoj katalogun e produkteve konform specifikave te prezantuara ne projekt dhe te ofroj certifikatat e kualitetit te materialit. OE duhet te ofrojë Marrëveshje me prodhuesin ose dilerin e autorizuar për furnizimin e produkteve për pozicionin e pllakave për hapësira te jashtme. Kërkesa 8- Operatori ekonomike duhet te dorëzoj autorizimin nga prodhuesi për pozicionet (1.4.10) Autorizimi nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (kopje). (mungojnë autorizimet nga prodhuesi apo dileri i autorizuar) Kërkesa 9- Operatori ekonomike duhet te dorëzoj raportet e testimit sipas standardit EN 13748-2 për pozicione e paramases me nr.(1.4.10) sipas standardit dhe për pozicionet (1.4.10). Si dëshmi të ofrohen certifikatat me standardet EC (Declaration of Conformity) në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive). Ne si Autoritet Kontraktues ne pamundësi te ngarkimit te projektit ekzekutimit ne. (mungon raportet e testimit sipas standardit EN 13748-2. Produkti te plotësoj standardet në vazhdim EC ose DOP (Declaration of Conformity). Produkti të posedoj shenjën CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 OE në dosje duhet të ngarkoj katalogun e produkteve konform specifikave te prezantuara ne projekt dhe te ofroj certifikatat e kualitetit te materialit. OE duhet te ofrojë. Marrëveshje me prodhuesin ose dilerin e autorizuar për furnizimin e produkteve për pozicionin e pllakave për hapësira te jashtme. Dëshmia 9 raportet e testimit sipas standardit EN 13748-2 për pozicione e paramases me nr.(1.4.10) sipas standardit dhe për pozicionet (1.4.10). Si dëshmi të ofrohen certifikatat me standardet EC (Declaration of Conformity) në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive). (mungojn e dëshmit e kerkuara per autorizmet dhe katalogjet) 1.Të gjitha pretendimet tuaja ankimore lidhur me papërgjegjshmërinë e OE të propozuar për kontratë , janë të paqëndrueshme. Andaj duke u mbështet në këto fakte. Autoriteti Kontraktues, vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 255/2024, ndërsa me datë 08.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/255 me rekomandimet si në vijim: Duke pasur parasysh zhvillimin e procedurës se prokurimit, pretendimet ankimore, kriteret te dosjes se tenderti ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konform shtjellimeve dhe elaborimeve ne ekspertiz te cekura si me larte kërkoj nga paneli shqyrtues qe te Aprovoj pjesërisht si te bazuar ankesën e operatorit ekonomik dhe njëkohësisht te lere ne fuqi njoftimin mbi vendimin e AK dhe Letrat Standarde për dhënie te kontratës se operatorit ekonomik te rekomanduar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues është Pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit. Ndërsa OE Nuk është Pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Vlerësimi i pretendimit ankimor OE “Archi Time” Sh.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/255 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “:Autoriteti Kontraktues ne dosjen e tenderti ka kërkuar si vijon: a. Dëshmi mbi përvojën e punës të Inxhinierit të Licencuar nga MPMS për Menaxhimin e Emergjencave në lëmin e Sigurisë, Mbrojtjes dhe Shëndetit në Punë dhe b.CV-ia dhe Dëshmi mbi përvojën e punës të Ekspertit për SSHP (siguri dhe shëndet ne pune) të certifikuar nga MPMS. Grupi i operatoreve ekonomik te rekomanduar për kontratë nga ana e AK-së konform DT-së ka dorëzuar listën e punëtorëve dhe Licencën për punëtorin e Menaxhimin e Emergjencave në lëmin e Sigurisë, Mbrojtjes dhe Shëndetit në Punë. I njëjti ka edhe kontratën e punës konform kërkesës se dosjes se tenderit, e cila është e bashkangjitur ne ekspertize. Lidhur me mungesën e CV autoriteti kontraktues konform Nenit 71 te LPP dhe Rregullores nr.001/2023 te Prokurimit Publik pikës 10 ka mundësin e kërkesës se sqarimeve lidhur me këtë andaj bazuar ne këtë pretendimi ankimore është pjesërisht i bazuar.”

Konstatimi i dytë (II) : “Operatori ekonomik ka dorëzuar pajisjet e kërkuara ne dosjen e tenderit po ashtu i njëjti ka dorëzuar edhe Kamionët e kërkuara ne DT. Po ashtu ne librezat e automjeteve-kamioneve vërehet se grupi i operatoreve ekonomik ka prezantuar pesë (5) kamion te cilët plotësoj kërkesën e AK pasi qe është kërkuar të jenë 15 deri 20 tonë peshë bartëse dhe te cilët peshën e ngarkesës e kanë konform kërkesave te AK-së, dhe ne cilësinë e eksperti konstatoj se kërkesa, kamionet e prezantuar nga Grupi i OE plotësojnë kriterin e kërkuar dhe konstatoj se pretendimi ankimore është i pa bazuar.”

Konstatimi i tretë (III) : “Operatori ekonomik i rekomanduar ka derguar ne ofertë gjithsejt 52 Certifikata te stafit për certifikim Siguria dhe Shendeti ne Punë si dëshmi po bashkangjes nje Certifikat te tillë. Autoriteti kontraktues ne Njoftimin për Kontrat dhe Dosjen e tenderti ka kërkuar si ne vijim: Kërkesa: 3.4 Kompania duhet të ketë stafin e trajnuar dhe të certefikuar për SSHP (siguri dhe shëndet në punë) për së paku 20 punëtorë. Dëshmia: 3.4 Dëshmi mbi stafin e trajnuar dhe të certefikuar për SSHP (siguri dhe shëndet në punë) për së paku 20 punëtorë. Që në këtë rast, këtë pikë te kërkesës se AK-së nuk është kërkuar qe te kenë Kontrata te punës keta punëtorë te certifikuar per Siguri dhe shendet ne punë lidhur me këtë projekt andaj bazuar ne këtë pretendimi ankimore është i pa bazuar.”

Konstatimi i katërt (IV) : “Ne baze te Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik Nenit 40, AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Andaj gabimi aritmetik nuk është mbi 2% te vlerës totale te ofertës dhe ne këtë rast pretendimi ankimore nuk mundet qe te mirret si i bazuar pasi gabimi aritmetik është shumë më i vogël se sa 2%.”

Konstatimi i pestë (V) : “Autoriteti kontraktues eliminimin e ofertës se operatorit ekonomik ankues ne baze te letrës standarde e ka bërë për mos plotësimin e këtyre kërkesave si me poshtë: 1. Një ngjeshës cylinder 25-30 ton. Luge Ngarkuese me zingjir 20 deri 22 ton – 1 cope Ngarkues 32 deri 35 ton – 1 cope. Makinë ngjeshëse e montuar në eskavator 800 deri 1000kg – 1 cope. Greder 8 deri 12 ton – 1 cope. Greder 18 deri 20 ton – 1 cope. Bulldozher 10 deri 15t – 1 cope, Kompresor ajri me tërheqje me regjistrim valid – 1 cope. Luge me nofulla shtrenguese hidrualike 1500 deri ne 2000 kg – 1 cope. Përgjigja e Ekspertit shqyrtues lidhur me eliminimin e pikës 1: Operatori ekonomik ankuese ne baze te kërkesës se dosjes se tenderti ka dorëzuar listën e pajisjeve se bashku me dëshmitë Kontrata dhe Kontrata për shfrytëzim. Në ekspertize janë te bashkangjitur lista me te gjitha pajisjet e kërkuara nga ana e AK-së. Për çdo pasije qe AK ka pasur dilema te kuptimit te saj ne baze te LPP-së Nenit 71 ka pasur mundësin e kërkitimit te sqarimit te çdo dokumenti apo pajisje te ofruara nga ana e OE, bazuar ne dëshmitë e dokumenteve ne ofertë OE ankuese posedon këto pajisje, andaj pretendimi ankimore ne këtë pikës është i bazuar. 2.Kërkesa - Prodhuesi i pllakave për hapësira te jashtme të jetë i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë) për system hermetik te makinerisë prodhuese. Produkti te plotësoj standardet në vazhdim EC ose DOP (Declaration of Conformity). Produkti të posedoj shenjën CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 (mungon dëshmia e kërkuar te prodhuesi I pllakave per hapësira te jashtme te jete) Dëshmia 9 raportet e testimit sipas standardit EN 13748-2 për pozicione e paramases me nr.(1.4.10) sipas standardit dhe për pozicionet (1.4.10). Si dëshmi të ofrohen certifikatat me standardet EC (Declaration of Conformity) në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive). (mungojnë dëshmitë e kërkuara te Iso standardit) (

mungon deshmia e kerkuar) Përgjigja e Ekspertit shqyrtues lidhur me eliminimin e pikës 2: Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në cilësinë e ekspertit shqyrtues kam kuptuar se prodhues i pllakave është kompania „Arfen Insaat Ve Yapi Teknolojleri San . Ve Tic. A.S., nga Turquia, i njëjti prodhues është i certifikuar për ISO 10002:2018. por i njëjti në dosjen e tenderit nuk ka të prezantuar certifikatën ISO 9001:2015 sipas kërkesë së DT-së. Po ashtu operatori ekonomik ka dorëzuar edhe disa raporte të testimit për të cilat nuk janë sipas standardit të kërkuar nga ana e AK -së (EN 13748-2) por kanë këtë standard (en 13501-1:2018). Standardi EN 13748-2 (I kërkuar nga AK) është një standard evropian që trajton pllakat për përdorim të jashtëm, në zonat ku lëvizin me këmbë. Standardi EN 13501-1:2018 (I ofruar nga OE) është një standard evropian që trajton klasifikimin e reagimit ndaj zjarrit të produkteve të ndërtimit dhe elementeve të ndërtimit. 4.Kërkesa 8- Operatori ekonomike duhet të dorëzojë autorizimin nga prodhuesi për pozicionet (1.4.10) Autorizimi nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (kopje). (mungojnë autorizimet nga prodhuesi apo dileri I autorizuar) Vemendje.Gjate procedurave të tenderimit ofertuesi duhet të prezantojë katalogun e produkteve konform specifikave të prezantuara në projekt dhe të ofrojë certifikatat e kualitetit të materialit. OE duhet të ofrojë Marrëveshje me prodhuesin ose dilerin e autorizuar për furnizimin e produkteve për pozicionin e pllakave për hapësira të jashtme. Përgjigja e Ekspertit shqyrtues lidhur me eliminimin e pikës 3: Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit kam kuptuar se prodhuesi i pllakave është „Arfen Insaat Ve Yapi Teknolojleri San . Ve Tic. A.S., nga Turquia, për të njëjtin OE ofertues nuk ka prezantuar Autorizimin nga prodhuesi ose dileri i autorizuar). Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP- së, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Archi Time” Sh.P.K.” Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Archi Time” Sh.P.K.” janë pjesërisht të bazuar.

Rekomandimi Ekspertit Shqyrtues;

“Paneli shqyrtues ta aprovoj pjesërisht si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik dhe njëkohësisht ta lërë në fuqi njoftimin mbi vendimin e AK dhe Letrat Standarde për dhënie të kontratës së operatorit ekonomik të rekomanduar”.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe

të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës të këtij aktiviteti të prokurimit, raportit të ekspertit shqyrtues me rekomandim, me shumice të thjeshte të votave, me dy (2) vota për dhe një (1) votë kundër ka vendosur; për mos e pranuar/ mbështetur rekomandimin e ekspertit shqyrtues për aprovimin e pjesërisht të ankesës së OE ankues dhe lënjen në fuqi të vendimit të AK-së; për anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe kthimin e lëndës në rivlersim; për të aprovuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankues "Archi Time" Sh.P.K me arsyetim si në vijim;"Eksperti shqyrtues kontradiktor po më duket, tek pretendimi 1. është kërkuar Dëshmi mbi përvojën e punës të Inxhinierit të Licencuar nga MPMS për Menaxhimin e Emergjencave në lëmin e Sigurisë, Mbrojtjes dhe Shëndetit në Punë, ndërsa tek certifikata e inxhinierit Muhamet Hamiti askund nuk figuron se kjo licencë është për menaxhim të emergjencave, kështu që duhet të sqarohet në fazën e ri-vlerësimit. Po ashtu, tek pretendimi 3. është kërkuar Kompania duhet të ketë stafin e trajnuar dhe të certifikuar për SSHP (siguri dhe shëndet në punë) për së paku 20 punëtorë. Është fakt se për këtë punëtor nuk janë kërkuar kontratat, por Kompania fituese në një form apo tjetër duhet të dëshmojë se i ka staf, sepse Kompania fituese e cila është në konzorcium edhe me dy kompani tjera, kanë paraqitur stafin e tyre që nuk është pjesë e kësaj liste, edhe për këtë duhet me u sqaru. Tek pretendimi 4. Edhe ankuesi edhe eksperti e kanë konstatuar se ka gabime aritmetikore nën 2 %, por AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore për të vepruar sipas tyre, ngase me Rregullore neni 40.09 "Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B49. në rast se OE në fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjale do të refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. Kështu që AK nuk ka vepruar.

Marr parasysh vlerën e këtij aktiviteti konsideroj që kjo lëndë duhet të kthehet në rivlerësim të sqarohen pikat si në vijim për OE të rekomanduar: Sipas kërkesës së AK në DT tek kërkesa për Inxhinierin e Licencuar nga MPMS për Menaxhimin e Emergjencave në lëmin e Sigurisë, Mbrojtjes dhe Shëndetit në Punë, OE i rekomanduar ka ofruar certifikata e inxhinierit z.Muhamet Hamiti megjithatë është evidente se certifikata e till nuk mbulon menaxhimin e emergjencave, njëjtë sikurse edhe vet ankuesi. Nga ana tjetër eksperti e ka cilësuar duke pohuar: Lidhur me mungesën e CV autoriteti kontraktues konform Nenit 71 të LPP dhe Rregullores nr.001/2023 të Prokurimit Publik pikës 10 ka mundësin e kërkesës së sqarimeve lidhur me këtë andaj bazuar në këtë pretendim ankimore është pjesërisht i bazar, por megjithatë ka rekomandur të mbetet në fuqi vendimi i AK, i cili trajtim nga ana e ekspertit konsideroj që është kundërtë në veten. Andaj konsideroj që kete pikë AK duhet të sqarohet në fazën e ri-vlerësimit. Ankuesi me tej ka pohuar se OE të rekomanduar, i mungojnë kontratat e punës ose kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt për stafin e trajnuar dhe të certifikuar për SSHP (siguri dhe shëndet në punë). Eksperti ka vlerësuar njëjtë dhe në mënyrë kontradiktore edhe në këtë pikë i njëjti ka konstatuar pretendimin si pjesërisht të bazuar, megjithatë ka rekomanduar të mbesë në fuqi vendimi i AK edhe pse shprehimisht në DT është kërkuar Kompania duhet të ketë stafin e trajnuar dhe të certifikuar për SSHP (siguri dhe shëndet në punë) për së paku 20 punëtorë. Eksperti ka konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar ka dërguar në ofertë gjithsej 52 Certifikata të stafit për certifikim Siguria dhe Shëndeti në Punë si dëshmi po bashkë me një Certifikatë të tillë. Duke aluduar se në këtë rast, këtë pikë të kërkesës së AK-së nuk është kërkuar që të kenë Kontrata të punës keta punëtorë të certifikuar për Siguri dhe shëndet në punë lidhur me këtë projekt. Megjithatë fjala staf nënkupton stafi i punësuar i OE dhe jo çdo certifikatë që mund ta gjej OE ta procedoj në ofertën e tij të konsiderohet e mirëqenë. Eksperti nuk ka ofruar argumente bindëse edhe për kete pikë. Kompania fituese në një form apo tjetër duhet të dëshmojë se i ka staf gjatë procedurës së rivlerësimit konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit pjesërisht të ankesës së OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër përfundimisht Paneli shqyrtues me shumicë të votave, me dy (2) vota për dhe një (1) kundër, vendosi si në dispozitave të vendimit.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - " ARCHI TIME " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: